

URDHËR
Nr. 226, datë 6.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Lindita Kareco, Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Gjyqësore për sa vijon:

- Për të nënshkruar aktet e ndërmjetme që i paraqiten gjykatës, lidhur me proceset gjyqësore të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga drejtori i përgjithshëm, si: deklarata mbrojtjeje, parashtrime, prapësime, konkluzione përfundimtare, kërkesa për shtim/saktësim objekti apo kërkesa të tjera procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit, pjesë e fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, që i paraqiten gjykatës në funksion të zhvillimit dhe ecurisë së proceseve gjyqësore.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve Gjyqësore nëse e gjykon të nevojshme, mund t’i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm aktet që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin nënshkrimin e autorizimit për përfaqësim gjyqësor, ankimet, rekursat apo aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen, dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të Përgjegjësit të Sektorit të Çështjeve Gjyqësore, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, të Kodit të Procedurës Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor, Sektori i Çështjeve Gjyqësore dhe znj. Lindita Kareco, dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhbelli